

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**NË EMËR TË POPULLIT**

**P. nr.970/18**

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICËS-departamenti i përgjithshëm**, gjyqtari i vetëm gjykues Gezim Ademi, dhe procesmbajtësja Hasnije Muhaxheri, ne lenden penale ndaj te pandehurit S.L.1 me vendbanim ne Rr. “...” nr. ... .. për shkak te veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 ne lidhur me par. 1 te KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës te Prokurorisë Themelore ne Mitrovice- PP.II.nr.3103/18 te datës 05.11.2019 pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar te dt. 26.02.2019, ne mungese te PTH. Natasha Radoviq e ne prezence te te pandehurit e ne te njëjtën dite publikisht shpall ketë, ndërsa me dt. 27.02.2019 përpiloi ketë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri: S.L.1, nga i ati H., e ëma F., e vajzërisë H., i lindur me dt. ... në ... me vendbanim ne rr. ... nr. ... .., me numër personal ..., i martuar, baba i katër fëmijëve, ka te kryer shkollën fillore, i gjendjes se dobët ekonomike, me pare i dënuar ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar, shtetas i Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:** Me dt. 17.08.2018 rreth orës 05:20 në ..., ne shtëpinë e vet ne rr. “...” nr. ..., i ka shkaktuar lëndime te lehta trupore te dëmtuarës S.L.2, ne atë mënyrë qe pas një grindjeje paraprake me te dëmtuarën, fizikisht e ka sulmuar te dëmtuarën dhe i ka rene shuplake ne fytyre dhe i ka shkaktuar lëndime te lehta trupore ne forme te ënjtjes ne faqen e majte, këto lëndime janë shkaktuar nga një mjet i forte mekanik dhe janë te karakterit te përkohshëm për shëndetin.

Me këtë ka kryer veprën penale: **Lëndim i lehte trupor nga neni 188 par. 3 ne lidhje me par.1 të KPRK-ës.**

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 4,7,8,9,10,21,41,45,73, dhe 188 par. 3 ne lidhje me par.1 te KPRK-se, dhe nenin 365, 450 dhe 463 te KPP-ës e:

**G J Y K O N**

**ME DENIM BURU ne kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj** i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari qe t’i paguaj shpenzimet procedurale dhe atë për ekspertizën mjekoligjor shumen prej 20€, ndërsa në emër të fondit për kompensimin e viktimave te krimit, shumen prej 30 euro, dhe ne emër te paushallit gjyqësor shumen prej 20 euro, të gjitha këto është i obliguar qe t’i paguaj ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nen kërcënimin e përmbarimit te dhunshëm.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest te rregullt civil.

## **A r s y e t i m**

**Prokuroria Themelore ne Mitrovice** - ka ngritur aktakuze PP.II.nr.3103/18 te datës 05.11.2019, kundër të pandehurit S.L.1 nga ..., për shkak te veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 ne lidhur me par. 1 te KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt. 26.02.2019 ashtu qe ne këtë seance i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar: e pranoj fajësinë, me vjen keq për rastin qe ka ndodhur, dhe i premtom gjykatës se nuk do te përsëris ne te ardhmen vepra penale, këtë e bëjë me vullnet dhe pa presionin e askujt.

Lidhur me pranimin e fajësisë prokurori i ka propozuar gjykatës që të pranohet fajësia e te pandehurit nga se pranimi i fajësisë nga i njëjti ishte pa presion pa dhune me vullnet dhe i propozon gjykatës qe te bej pranimin e fajësisë dhe kjo behet si rrethane lehtësuese ne anën e te pandehurit si dhe faktet se vazhdon te jetoj me bashkëshorten, se kane katër fëmijë, se është ne gjendje te dobët materiale, dhe nga te gjitha këto gjykata te merre rrethana lehtësuese.

### **I. Vlerësimi i pranimit te fajësisë.**

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte ne përputhje me neni 248 pasi qe i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bene ne mënyrë vullnetare, pas sqarimeve te mjaftueshme nga ana e gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje te qarte ligjore apo gabime faktike qe do te bënin te pamundur qe gjykata te beje vlerësimin e pranimit te fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban akuza, te gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë ne përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat qe gjenden ne shkresat e lendes si: Raporti policor i dt.17.08.2018, Te behet vështrimi ne raportin e mjekut ne emër te te dëmtuarit nr. ... te dt. 17.08.2018, ekstraktin nga dosja penale ne emër te pandehurit te dt. 08.2018, konstatimin dhe mendimin te mjekësisë nga ... te dt. 30.08.2018, nga te gjitha këto si dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e te pandehurit vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 ne lidhur me par. 1 te KPRK-se.

### **II. Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.**

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo vepër penale është e dënueshme me dënim me burgim prej tre (3) muaj deri ne tre (3) vjet, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese, kjo gjykate si rrethana renduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale rrethanat ne te cilat ishte kryer vepra penale, si rrethane tjetër renduese gjykata ka gjetur se ne te dhënat e shkresave te lendes nga dosja kriminale është vërtetuar se i njëjti është kryerës edhe i shume veprave tjera penale.

Si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale te kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes se veprës penale, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e qe nga deklarimi i tij me rastin e pranimit te fajësisë i njëjti deklaronte se e ndien veten fajtor ky

deklarim i tille i te pandehurit për gjykatën shpreh një pendim te thelle te tij për veprën penale.

Nga te gjitha këto gjykata duke vlerësuar te gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit pasi qe për gjykatën ne rrethana te tilla mjafton dënimi i shqiptuar si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, do te ndaloj kryerësin qe te mos kryej vepra penale ne te ardhmen e qe ky është edhe qëllimi i dënimit. Nga te gjitha këto rrethana kjo gjykate vlerëson se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit.

### **III. Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.**

Lidhur me shpenzimet procedurale dhe atë për ekspertizën mjeko-ligjor shumen prej 20€, ndërsa në emër të fondit për kompensimin e viktimave te kriminit, shumen prej 30 euro, dhe ne emër te paushallit gjyqësor shumen prej 20 euro, të gjitha këto është i obliguar qe t'i paguaj ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nen kërcënimin e përmbarrimit te dhunshëm.

### **IV. Lidhur me kërkesën pasurore juridike.**

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata te dëmtuarit i ka udhëzuar ne konteste te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365, 450, te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P. nr.970/2018 dt.27.02.2019**

Procesmbajtësja :  
**Hasnije Muhaxheri**

Gjyqtari i vetëm gjykues  
**Gëzim Ademi**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kane te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, nëpërmes kësaj gjykate